



UDHËZUES PËR ZGJEDHJET E
KËSHILLIT TË NXËNËSVE TË
SHKOLLËS NË KOHË PANDEMIE

Të drejtat e autorit© 2020. Këshilli Rinor Kosovar (KYC)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të KYC.

Përgatitur nga: Këshilli Rinor Kosovar (KYC)

Ky udhëzues është shkruar në kuadër të projektit “Building a generation of impact through Student Council of Kosova” që mbështetet nga Fondacioni Gjerman ‘Schüler Helfen Leben’

Termet e përdorura

- **Këshilli i Nxënësve të Shkollës (KNSh)** – Përfaqësuesit e secilës klasë në shkollë, të zgjedhur nga votat e lira të nxënësve në klasat e tyre.
- **Kryesi** – Përfaqësuesit e Këshillit të Nxënësve të Shkollës, i cili formohet nga një përfaqësues i secilës paralele si dhe kryetari/ja dhe nën-kryetari/ja i/e Këshillit të Nxënësve të Shkollës, të zgjedhur nga votat e lira të nxënësve.
- **Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH)** – Organi më i lartë vendim-marrës në shkollë.
- **Monitoruesi/ja e KNSH-së** – Personi i përcaktuar nga KDSH-ja, për të monitoruar zgjedhjet dhe punën e Kryesisë së shkollës, i/e cili/a nuk ka të drejtë vote apo ndikimi në votim ose vendim.
- **Kujdestari/ja i/e klasës** – Mësimdhënësi përgjegjës për një klasë të caktuar në shkollë.
- **Moderim** – Udhëheqja e procesi të zgjedhjeve pa të drejtë vote apo ndikimi në vota ose vendim.
- **Përfaqësues/ja e/ klasës** mbron interesat dhe të drejtat e nxënësve brenda klasës. Organizon nxënësit në klasë dhe delegon kërkesat dhe ankesat e tyre tek kujdestarja/i i/e klasës, Këshilli i Nxënësve të Shkollës, drejtori/eshja dhe akterë të tjerë me ndikim.
- **Përfaqësuesi/ja i/e paralelës** mbron interesat dhe të drejtat e nxënësve të gjeneratës që përfaqëson. Organizon nxënësit e gjeneratës që përfaqëson si dhe angazhohet për kërkesat, ankesat e tyre. Po ashtu, delegon këto të fundit në instanca më të larta nëse është e nevojshme.
- **Udhëheqësi/ja e/ shkollës** mbron interesat dhe të drejtat e nxënësve të të gjithë shkollës. Ka për obligim të merret me ankesat dhe kërkesat e nxënësve të shkollës të deleguara nga përfaqësuesit e klasës apo paraleles. Mbi të gjitha, organizojnë nxënësit e shkollës për aktivitete të ndryshme si dhe përfaqësojnë zërin e nxënësve në Këshillin Drejtues të Shkollës.

- Ky udhëzues shërben për përshtatjen me gjendjen e pandemisë gjatë procesit të zgjedhjes së Këshillit të Nxënësve të Shkollës në tre nivele, atë të zgjedhjes së përfaqësuesit/es së klasës, paraleles dhe shkollës. Është i përshtatur në tre skenar potencial a. Kur të gjithë nxënësit janë në shkollë, b. Kur disa nxënës vijojnë mësimin virtual dhe të tjerë mësimin në hapësirat shkollore dhe c. Kur të gjithë nxënësit ndjekin mësimin në mënyrë virtuale.

- Zgjedhjet e Këshillit të Nxënësve të Shkollës këtë radhë kanë rëndësi akoma më të madhe si rezultat i përfshirjes në Task Forcë ku sipas Udhëzuesit të MASHT kjo task forcë do të paraqes raport tek kryetari i Komunës, Shtabi Emergjent Komunal lidhur mbi shëndetin, shërbimet publike në shkollë, sigurinë publike të nxënësve, mësimdhënësve në përgjithësi të stafit shkollor si dhe funksionimin e procesit mësimor, do të ndihmoj, këshilloj drejtorët e shkollave, mësimdhënësit dhe nxënësit. Kjo do të thotë që përgjegjësia e Këshillit të Nxënësve rritet dhe gjithashtu rëndësia e tyre për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor 2020/2021.

- Procesi duhet të realizohet në bazë të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik si mbajtja e distancës fizike, përdorimi i maskave dhe larja apo dezinfektimi i duarve vazhdimisht

ZGJEDHJET E KËSHILLIT TË
NXËNËSVE NË NIVEL KLASE



Kujdestari/ja i/e klasës do të iniciojë dhe moderoj procesin e zgjedhjeve për kryesi të klasës. Nxënësit do të propozojnë ose vetë-propozohen dhe do të shpalosin planet e tyre para nxënësve të klasës; të cilat duhet të bëhen nga vendi (banka) pa pasur nevojë për lëvizje në klasë. Pas përfundimit të diskutimit do të vazhdohet me zgjedhje me anë të votës së fshehtë. Kujdestari/ja i/e klasës do të mbledh votat nga secili nxënës përmes një kutie të votimit. Nxënësit udhëzohen të vendosin vetë votën në kuti. Kujdestari/ja i/e klasës pasi ka grumbulluar votat nga secili nxënës/e i/e klasës, inicion numërimin e votave. Pas shpalljes së rezultatit, kujdestari/ja i ruan votat e nxënësve për proces-verbal të procedurës së zgjedhjeve. Nxënësi/ja me më së shumti vota do të zgjedhet kryetar/e i/e klasës, ndërsa nxënësi/ja i/e dytë me më së shumti vota do të jetë nën-kryetar/e i/e klasës.



Nxënësit e një klase janë të ndarë në dy grupe. Kujdestari/ja i/e klasës do të mbledh propozimet për përfaqësues të klasës nga nxënësit në të dy grupet dhe të njëjtat propozime do të ndahen me nxënësit e klasës në të dy grupet së bashku me planet e tyre të punës, të printuara. Nxënësit, në grupe të ndara, me anë të votës së fshehtë do të votojnë për përfaqësuesit e tyre. Kujdestari/ja i/e klasës e ka për detyrim që të grumbulloj votat (të dezinfektojnë duart nxënësit pas votimit), ti numëroj (të dezinfektoj duart kujdestari/ja i/e klasës pas numërimit) dhe të nxjerr rezultatet e zgjedhjeve. Nxënësi me më së shumti vota do të zgjedhet kryetar/e i/e klasës, ndërsa nxënësi i dytë me më së shumti vota do të jetë nën-kryetar/e i/e klasës.



Nxënësit janë duke mbajtur mësimin online në tërësi. Kujdestari/ja i/e klasës duke u bazuar në planin organizativ të shkollës, duhet të krijojë një grup online me të gjithë nxënësit e klasës. Në atë grup do të iniciohet takimi për zgjedhjet e kryesisë së klasës. Pasi që të gjithë nxënësit kanë hy në takim, procedura do të jetë e njëjtë sikurse në zgjedhjet fizike të skenarit A në këtë kapitull. Nxënësit do të japin propozimet e tyre për kandidatët, do të prezantohen planet e punës dhe mbahet diskutim për to, do të votohet në mënyrë anonime dhe do të numërohen votat. Votimi i fshehtë është më vështirë të implementohet në platformat digjitale të mësimin online, andaj, vota do të i dërgohet kujdestarit/es direkt në mesazh privat në mënyrë që të mbrohet vota e nxënësve ose të krijohet një google form (anonime) e cila mund të shpërndahet tek nxënësit prezentë.

ZGJEDHJET E KËSHILLIT TË
NXËNËSVE NË NIVEL PARALELEJE



Drejtori/eshia i/e shkollës do të iniciojë procesin e zgjedhjeve për kryesinë e shkollës. Përfaqësuesit e klasave të një gjenerate të përbashkët, do të mbliidhen dhe do të iniciohen zgjedhjet për përfaqësues të paraleles (gjeneratës, vitit). Varësisht numrit të klasave në një paralele do të vendoset hapësira për ditën e zgjedhjeve. Nëse, numri i klasave në një paralele është më i madh se 15, atëherë shkollat udhëzohen që të mbajnë zgjedhjet për përfaqësues të paraleles në një ambient më të madh I cili krijon mundësi që secili nxënës të mbajë distancën prej 2m, si: holla i shkollës, korridoret e shkollës, biblioteka ose kabinete që janë më të mëdha në m² si dhe oborri i shkollës nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme. Nxënësit në takim, mund të propozojnë ose vetë-propozohen, të shpalosin planin e tyre të punës dhe të diskutojnë mbi qëllimet që ata tentojnë të realizojnë. Pas mbylljes së diskutimit vazhdohet me procedurën e votimit. Monitoruesi i zgjedhjeve i përcaktuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës, ka për detyrë të grumbulloj votat tek secili përfaqësues i klasës në një kuti të përbashkët të votimit. Pas grumbullimit, monitoruesi i zgjedhjeve, numëron votat dhe nxënësi që ka marrë më së shumti vota zgjedhet përfaqësues i nxënësve, personi i dytë, zgjedhet nën-kryetar/e. Proceduara e njëjtë përsëritet për çdo gjeneratë.

B Skenari

Në rastin kur nxënësit janë të ndarë me paralele, disa online dhe disa në shkollë, do të ndahen zgjedhjet paralele për paralele. Nëse klasat e 10-ta (p.sh.), janë duke mbajtur mësimin në shkollë, atëherë, monitoruesi i KNSh-së, i përcaktuar nga KDSH-ja, do të iniciojë zgjedhjet për atë gjeneratë që është në shkollë. Fillimisht, duhet të përcaktohet hapësira e përshtatshme për të mbajtur zgjedhjet, e cila duhet të mundësojë distancë të paktën 2m në mes përfaqësuesve. Nëse shkolla nuk ka hapësirë të përshtatshme, atëherë udhëzohen shkollat që të mbajnë zgjedhjet online. Në ditën e zgjedhjeve, nxënësit që kandidojnë për përfaqësues të gjeneratës së tyre, duhet të shpalosin planin e tyre para përfaqësuesve të klasave të asaj gjenerate, kjo duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe çdo herë duke respektuar distancën prej 2m. Pas diskutimeve mes nxënësve, monitoruesi/ja, do të iniciojë procesin e zgjedhjeve dhe nxënësit do të votojnë me anë të votës së fshehtë. Monitoruesi/ja do të grumbulloj votat nga secili përfaqësues në një kuti të përbashkët. Pas grumbullimit të votave, monitoruesi/ja i/e zgjedhjeve, numëron votat dhe nxënësi që ka marrë më së shumti vota zgjedhet përfaqësues i nxënësve të asaj gjenerate dhe automatikisht bëhet pjesë e Kryesisë së Këshillit të Nxënësve të Shkollës gjersa, personi i dytë më i votuar, zgjedhet nënkryetar/e.



Nxënësit janë duke mbajtur mësimin online në tërësi. Monitoruesi/ja i/e zgjedhjeve i deleguar nga Këshilli Drejtues i shkollës duke u bazuar në planin organizativ të shkollës, duhet të krijojë një grup online me të gjithë përfaqësuesit e klasave të një paraleleje. Në atë grup, do të iniciohet takimi për zgjedhjet e përfaqësuesit/es së paraleles. Pasi që të gjithë përfaqësuesit hyjnë në takim, procedura do të jetë e njëjtë si zgjedhjet fizike, në shkollë. Nxënësit do të japin propozimet e tyre për kandidatët, do të shpalosen planet e punës dhe do të mbahet diskutim për to, do të votohet në mënyrë anonime dhe do të numërohen votat. Votimi i fshehtë është më vështirë të implementohet në platformat digjitale të mësimin online, andaj, vota do të i dërgohet monitoruesit/es direkt në mesazh privat në mënyrë që të mbrohet vota e nxënësve ose të krijohet një google form (anonime) e cila mund të shpërndahet tek nxënësit prezentë.

ZGJEDHJET E KËSHILLIT TË
NXËNËSVE NË NIVEL SHKOLLE



Kur të gjithë nxënësit janë në shkollë, zgjedhjet për përfaqësues të nxënësve në nivel shkolle duhet të jenë shumë të kontrolluara shkaku i numrit të madhë të nxënësve. Duke pasur parasyshë që në takim do të jenë përfaqësuesit e secilës klasë në shkollë, hapësira e mbajtjes së mbledhjes për zgjedhjet e përfaqësuesve duhet të plotësojë kushtet për mbajtje 2m të distancës mes nxënësve, dezinfektues dhe të mbahen dritaret dhe dyert hapur për ajrosje. Nxënësit që kanë kandiduar për përfaqësues të shkollës do të dalin para Këshillit të Nxënësve të Shkollës, për të paraqitur planin e tyre të punës. Secili nga kandidatët duhet të ketë kohën e njëjtë për prezantim të planit të punës ndërsa përfaqësuesit në KNSh, duhet të ju ipet hapësira e nevojshme për pyetje në lidhje me planin e tyre të punës. Pas diskutimit, secili nxënës do të votojë në mënyrë të fshehtë dhe monitoruesi/ja e zgjedhjeve do të bëjë grumbullimin e votave përmes kutisë së votimit. Pasi që të gjithë nxënësit prezent kanë votuar, monitoruesi/ja para të gjithë nxënësve, do të bëjë grumbullimin e votave, ku kandidati/ja më i/e votuar do të zgjedhet Kryetar/e i/e Këshillit të Nxënësve të Shkollës dhe kandidati/ja më i/e votuar do të zgjedhet Nën-Kryetar/e i/e. Pas paraqitjes së rezultateve, nxënësit lëshojnë sallën.

B Skenari

Kur disa nga nxënësit janë në shkollë dhe disa janë duke ndjekur mësimin online, atëherë duhet të përcaktohet nga shkollat, mënyra se si do të mblidhet Këshilli i Nxënësve të Shkollës, online apo fizikisht, varësisht kushteve infrastrukturore dhe numrit të nxënësve. Nëse vendoset që zgjedhjet të mbahen fizikisht, atëherë monitoruesi/ja i/e Këshillit të Nxënësve, duhet të përcaktoj orarin më të përshtatshëm për të gjithë dhe të dërgoj ftesat për të gjithë përfaqësuesit e secilës klasë për të qenë prezent në zgjedhje. Më pas, duhet të ndjekin hapat e njëjtë sikurse në skenarin A për zgjedhjet e përfaqësuesve në nivel shkolle. Ndërsa, nëse vendoset që këto zgjedhje të mbahen online, atëherë duhet të ndjekin hapat e njëjtë, sikurse në skenarin C të këtij kapitulli.



Fillimisht, monitoruesi/ja i/e Këshillit të Nxënësve të Shkollës, duke u bazuar në planin organizativ të shkollës, duhet të krijojë një grup online më të gjithë përfaqësuesit e klasave të një paraleleje. Pastaj, duhet të përcaktojë një orar të përshtatshëm për të gjithë përfaqësuesit e secilës klasë në shkollë dhe të dërgoj ftesat virtuale me datë, orar të saktë si dhe linkun e platformës që do të përdoret për zgjedhje. Pasi që nxënësit janë bërë pjesë e takimit, kandidatët për përfaqësues do të shpaleshin planin e tyre të punës para nxënësve të tjerë dhe do të hapet diskutim për planet e prezantuara. Nxënësit mund të përdorin edhe prezantime të vizualizuara për ti shpërndarë me nxënësit e tjerë. Pas diskutimit, do të iniciohet procedura e votimit për përfaqësues të shkollës. Për të ruajtur fshehtësinë e votës, nxënësit udhëzohen që të dërgojnë votën e tyre si mesazh privat tek monitoruesi/ja i/e KNSh-së ose të krijohet një google form (anonime) e cila mund të shpërndahet tek nxënësit prezentë. Nëse është përdorur forma e parë, Monitoruesi/ja duhet të bëjë grumbullimin e votave dhe të numëroj ato para nxënësve të pranishëm. Kandidati/ja më i/e votuar do të zgjedhet Kryetar/e i/e Këshillit të Nxënësve të Shkollës dhe kandidati/ja më i/e votuar do të zgjedhet Nën-Kryetar/e i/e.

